Nr. 1058. Prot
Dt 08.02.18

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER
SEKTORI JURIDIK

Nr147/1 Prot

Shkodër, më 08.02.2018

LËNDA:Lidhur me VKB Malësi e Madhe Nr.8 datë 22.01.2018.

DREJTUAR: KËSHILLIT TË BASHKISË MALËSI E MADHE.

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale përcaktuar në dispozitat e ligjit Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" neni 8 germa a, neni 16,ligjit Nr.139/2015 "Per veteqeverisjen vendore" neni 9 pika 1.3 shkronja "b", neni 34 pika 6, neni 35 pika 5, nenit 54 shkronja "f", neni 55/3, ligjit 9975, datë 28.07.2008 "Per taksat kombetare", i ndryshuar; ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar, ligjit nr.10081 datë 23.02.2009 "Për liçencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjit nr. 8378 datë 22.7.1998 "Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar, ligjit nr.99207 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjit nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 14 dhe 16, ligjit Nr.10279 datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative",Ligji Nr.9482 datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndertimeve pa leje" i ndryshuar, Ligji nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar, Ligjit Nr.8308 datë18.03.1998 "Për transportet rrugore" i ndryshuar, Ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar, Ligjit nr.24/2017 "Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit", Ligji nr.152/2015 date 21.12.2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi", VKM nr. 784 dt 9.11.2016 "Për mënyrën dhe kriteret e llogaritjes së shpenzimeve të ndërhyrjes për shuarjen e zjarreve në objektet e siguruara nga zjarri dhe administrimin e përdorimin e të ardhurave, për llogari të shërbimit vendor të Mzsh-së",VKM nr.970 datë 02.12.2015, "Për përcaktimin e proçedurave dhe të kushteve për dhënien e liçencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar, VKM nr.438 datë 8.06.2016, " Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore", shqyrtoi vendimin e këshillit te Bashkise Malësi e Madhe Nr.8 dt.22.02.2018 "Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2018 materiali bashkelidhur me nr.1-35 faqe).

Pas shqyrtimit, Prefekti konstaton :

Lidhur me Taksën e ndikimit në infrastrukturë për rastet kur subjekti posedon më shumë se një ndertim pa leje. Sqarojme se ne raste te tilla ne zbatim te pikes 1 dhe 2

te nenit 25 te ligjit 9482 datë 03.04.2006 "Për legalizimin,urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje"i ndryshuar, taksa e ndikimit në infrastrukture për ndertimin e dyte eshte ne perputhje me ligji Nr. 9632/2006, i ndryshuar.

1. Ne kap.II.1,**Tarifa e pastrimit dhe largimit te mbeturinave si dhe tarifa e ndricimit dhe gjelberimit,** ne **tabelen II.1.a** tarifat për familjet, kategorizimi i njesive dhe fshatrave nuk eshte bëre në përputhje me emertimet e ligjit Nr.115/2014 dt.31.07.2014 "Për ndarjen adminsitrativo-territoriale të Njësive të Qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë" nuk jeni te sakte ne percaktimin e njesive dhe fshatrave ku kryeni shërbimin e pastrimit dhe largimit te mbeturinave p.sh. shpreheni njesite administrative Qender Kelmend etj. Tarifa e lartpermendur duhet te mblidhet ne zona e fshatra ku e kryeni sherbimin dhe duhet te jete e percaktuar qarte ne vkb tuaj sipas NJ.A dhe fshatrave. Konstatojme ne kundershtim me nenin 14 pika 2 dhe 3 te ligjit nr.68/2017 datë 27.04.2017 qe kerkon qe sherbimi publik te jete i matshem per perdoruesit dhe perfituesit, tarifen e pastrimit, ndricimit dhe gjelberimit per kategorine biznes (tabela10), institucione (tabela11), subjekte ndertimi (tabela12), transport (tabela13) eshte permbledhur në një tarifë. Në zbatim të pikës 2 të nenit 14 te ligjit 68/2017 qe kerkon qe niveli i tarifës te orientohet në mbulimin e kostos së shërbimit publik të ofruar, keto tarifa duhet ti vendosni te ndara, pra te percaktoni tarifen e pastrimit dhe largimit te mbeturinave, tarifën e ndriçimit publik dhe tarifen e gjelberimit sipas \zonave ku i ofroni këto shërbime.(të rishqyrtohet dhe te saktesohet).
2. Ne kap. II.4. **Te ardhura nga sherbimi pyjor,** në tabelën 16, planifikoni të ardhura nga pyjet dhe kullotat, në një kohe që planifikimi i te ardhurave per vitin 2018, bëhet ne buxhetin perkates të vitit. Në zbatim të ndryshimeve te reja ligjore per pyjet dhe administrimin e tyre eshte Struktura pergjegjese per pyjet dhe kullotat ne Bashki ç'do vit harton dhe dërgon per miratim në Ministrinë përgjegjëse për pyjet planin e shfrytëzimit te pyjeve dhe te prodhimeve te dyta pyjore e jopyjore, drejtoria perkatese e ministrise pergjegjese per pyjet kontrollon zbatimin e këtij plani"(ligji nr.48/2016 "Per disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr.9385 dt.4.05.2005 "Për pyjet dhe sherbimin pyjor" te ndryshuar).Në zbatim të VKM Nr.438 datë 8.6.2016 shfrytëzimi i fondit pyjor kombëtar organizohet mbi bazën e vitit pyjor, i cili fillon më 1 tetor dhe përfundon në 30 shtator të vitit pasardhës dhe se procedurat duhet të jenë sipas Udhëzimit nr.1 datë 9.6.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik" me tarifat që përcaktohen në VKM nr.391 datë 21.6.2006, i ndryshuar. Theksojmë se baza ligjore që citoni (ligji 68/2017 neni 14 pika 5 germa ë) nuk ka të bëjë me tarifat e sektorit pyjor pasi ato jane përcaktuar me akte ligjore të veçanta.
3. Ne kap.II. **Tarifa të sektorit të kontrollit të zhvillimit urbanistik e pronave, të tabela 17** është pjesërisht e vlefshme lidhur me pikën 4 të tabelës tarifë kontrolli tarifat e vendosura nga ana e juaj për kontrollet e pikëtimit, kuotës 0.00, karabina etj të objekteve në ndërtim,eshte detyre funksionle e Inspektoriatit te Mbrojtjes te territorit te njesise vendore ne baze te planit te punes verifikon edhe akt kontrollin e

kuotes 0,00 pjese e dosjes te dokumentacionit tekniko-ligjor, pika 3 e VKM Nr.894 dt.4.11.2015 "Per unifikimin e procedurave te kontrollit te territorit nga inspektoriati kombetar I mbrojtjes te territorit dhe ai I njesise vendore.

4. Ne kap. II.8. **Tarife e përkohshme per linjat ajrore dhe nëntokesore**, janë jo të argumentuar pasi ligji nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 14 pika 3 dhe pika 5/dh citojn "në përputhje me rrethana të përcaktuara në ligj".
5. Në zbatim të ligjit Nr.10279 datë 20.5.2010 ***"Për kundërvajtjet administrative"*, neni 6 germa b,** "Shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative parashikohen:.... b) me akte të këshillit bashkiak, për shkelje që nuk janë parashikuar si të tilla në ligje të veçanta". Rekomandohet miratimi i një vendimi te veçante të Keshillit Bashkiak për përcaktim të shkeljeve që përbëjnë kundërvajtje administrative dhe vendosjen e gjobave përkatese.
6. Ne kap. III.2. **Gjobat (fq 33)** (tabela 25 pika III.2.a) per mosshlyerje të detyrimeve tatimore brenda afatit keni vendosur gjobe 0.06 % për çdo ditë vonesë të vlerës së detyrimit, maksimumi 25 % ne kundershtim me nenin 114 te ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"* (i ndryshuar) që parashikon gjobë në masën 0.06 % te detyrimit për ç'do ditë vonesë dhe për një periudhë jo më të gjatë se 365 dite kalendarike dhe maksimumi i gjobes eshte 365 dite x 0.06 % = 21.9 %. Denimi per *kundravajtjen mosafishim i çmimit te shitjes eshte* vendosur ne masen 8.000 leke ne kundershtim me nenin 130 te ligjit qe e parashikon ne masen 50.000 leke. Denimin per mosafishimin e Niptit ne masen 3.000 leke eshte vendosur ne kundershtim me ligjin 9920/2008 ndryshuar qe nuk e parashikon nje mase te tille. Për moslejim të ushtrimit të kontrollit keni vendosur gjobe ne masen 20.000 leke ne kundershtim me nenin 127 të ligjit Nr.9920/2008 i ndryshuar qe parashikon gjobe ne masën e 100.000 leke.

Sa me sipër, Prefekti ju autorizon të procedoni për pjesën e vlefshme të sistemit fiskal, por në një tjetër mbledhje jeni të detyruar të korigjoni pjesën e trajtuar më sipër.
Sjellim në vemendjen tuaj se me ligjin nr.106/2017, date 30.11.2017 "Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr. 9632, date 30.10.2006 "Per sistemin e taksave vendore", i *ndryshuar*", qe hyn ne fuqi me 1 Prill 2018, ndryshojne taksa e nderteses, taksa e tabeles dhe taksa e ndikimit ne infrastrukture.

Me respekt,

PREFEKTI

Çesk MILLJA

Adresa:"Rruga 28 Nentori", Shkoder,Telefon/Faks 000355 2224 27-05,e-mail:prefektura Shkoder@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALËSI E MADHE
KESHILLI BASHKIAK

Nr. 754 Prot.

Koplik, më 26 . 01 .2018

VENDIM

Nr. 8 date 22 .01.2018.

Këshilli Bashkiak Malësi e Madhe në mbledhjen e tij të datës 22.01.2018, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore "Për Miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2018" në mbështetje të nenit 18 te Ligjit nr. 139/2015 „Për Vetëqeverisjen Vendore" dhe te:

- Ligji nr. 139/2015 „Për Vetëqeverisjen Vendore" .
- Ligji nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore ", i ndryshuar.
- Ligji nr. 142/2015 " Per disa ndryshime dhe shtesa dhe shtesa ne ligjin nr.9632, dt 30.10.2006, "Per Sistemin e Taksave Vendore", te ndryshuar.
- Ligji nr. 68/2017, dt.27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"
- Ligji nr. 9975 „Për Taksat Kombëtare", i ndryshuar.
- Ligji nr. 8438 datë 28.12.1998 "Per Tatimin mbi te Ardhurat",i ndryshuar.
- Ligji nr. 109, datë 30.11.2017,"Për Buxhetin e vitit 2018"
- Ligji nr. 107 /2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit ",i ndryshuar
- Ligji nr. 9936 i datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH",i ndryshuar.
- Ligji nr.5 /2016 "Për Shpalljen e Moratoriumit në Republiken e Shqipërisë".
- Ligji nr.10465,datë 29.09.2011 "Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërise",i ndryshuar.
- Ligji nr.10/2016 „Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin.8308 i datës 18.03.1998 "Për Transportin Rrugor",i ndryshuar .
- Ligji nr.152/ 2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri"
- Ligji nr.9920 datë 19.05.2008 „Për procedurat Tatimore në R.SH." të ndryshuar me ligjin nr. 164\2014.
- Ligji nr.10463,datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të Mbetjeve Urbane",i ndryshuar.
- Ligji nr.8308,datë 18.03.1998 "Për Transportin Rrugor",i ndryshuar.
- Ligji nr.10279,datë 20.05.2010 "Për Kundravajtjet administrative".
- Ligji nr.10296,datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin",i ndryshuar.
- Ligji nr.10081,datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar

Adresa: Koplik-Qender tel.021122650/2651 e-mail:bashkiamalesiemadhe@hotmail.com

- Ligji nr.10304, datë 15.7.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë"
- Ligji nr.8378, dt.22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligji nr.24/2017 " Për Administrimin e Ujitjes dhe Kullimit", miratuar me dt.09.03.2017.
- Ligji nr.106/2017 " Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632, datë.30.10.2006, "Për Sistemin e Taksave Vendore", të ndryshuar.

Vendime dhe udhëzime:

- VKM nr.783 datë 10.11.2011 "Për procedurat e ndarjes së të ardhurave të taksës vjetore të mjeteve të përdorura në njesitë e qeverisjes vendore",i ndryshuar.
- VKM nr.408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e zhvillimit të territorit ",i ndryshuar.
- Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.2 i datës 06.02.2012 "Për Procedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit",i ndryshuar.
- VKM nr.433 datë 08.06.2016,"Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave të inventarit".
- VKM nr.438 datë 08.06.2016 „Për Kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të Pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore".
- Udhëzimi nr.01,datë 09.06.2016 „Për rregullat dhe proçedurat e kërkimit të shqyrtimit e miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor e kullosor e publik".
- Udhëzim nr.2,datë 20.07.2016 "Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave,dhe livadheve të procedurave për dhënien e tyre për kullotje dhe kositje bari"
- Udhëzimin nr.5627,datë 18.11.2016 "Për përcaktimin e kritereve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në Transportin Rrugor të udhëtarve brenda vendit".
- VKM nr.285,datë 27.06.2002 "Për tarifat e shërbimeve që kryen policia e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit ndaj shtetasve dhe përsonave,juridike fizike e vendas e të huaj."
- VKM nr.707,datë 12.10.2016 'Për Tarifën e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit të ofruara nga bashkitë e paisura me stacione të këtij shërbimi,në territorin e bashkive që nuk kanë stacione shërbimi të MZSH."
- Vendim nr.1064,datë 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave".
- Udhëzim nr.1,datë 09.06.2016 "Për rregullat procedurat e kërkimit të shqyrtimit të miratimit të kerkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik".
- VKM nr.970,datë 02.12.2015 "Për Përcaktimin e Proçedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe të nënprodukteve të saj",i ndryshuar.
- VKM nr.1096,datë 28.12.2015 "Për Miratimin e rregullave, kushteve dhe procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike".
- VKM nr.54,datë 05.02.2014 „Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar .
- Udhëzimi nr.30,datë 27.12.2011,"Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik",i ndryshuar.
- Shkresës së Ministrit të Financave nr.17905/1, datë 27.12.2016 "Për miratimin e ndryshimeve dhe shtesat në tarifat e pagesave për licenca/çertifikata".

Adresa: Koplik-Qender tel.021122650/2651 e-mail:bashkiamalesiemadhe@hotmail.com

- VKM Nr.7, datë 4.01.2012, "Për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare",i ndryshuar.

V E N D O S I

1. Të miratojë paketen fiskale të vitit 2018 për Bashkinë Malësi e Madhe.
2. U miratua me datë 22.01.2018.
3. Ky vendim u shpall me datë 26 .01. 2018.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55/6 të ligjit nr 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

SEKRETARI

EMIRJAN HASMUJAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALËSI E MADHE

KRYETARI

ILIR HALAJ

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA MALESI E MADHE
ZYRA E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

PAKETA FISKALE 2018

BASHKIA MALESI E MADHE



1.Kuadri ligjor dhe nënligjor.

Ligji nr 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, përbën ligjin bazë për reformat e decentralizimit të pushtetit vendor dhe përcakton rregullat për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të njësive të qeverisjes vendore në drejtim të krijimit të taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre. Më poshtë si vijon janë paraqitur ndryshimet e këtij ligji si dhe gjithë kuadri tjetër ligjor dhe nënligjor në të cilën jemi bazuar për të paraqitur taksat dhe tarifat vendore për vitin 2018.

Ligje:

- Ligji nr. 139/2015 „Për Vetqeverisjen Vendore“ .
- Ligji nr. 9632 dt 30.10.2006 “Per Sistemin e Taksave Vendore “ i ndryshuar.
- Ligji nr. 142/2015 “ Per disa ndryshime dhe shtesa dhe shtesa ne ligjin nr.9632, dt 30.10.2006, “Per Sistemin e Taksave Vendore”, te ndryshuar.
- Ligji nr. 68/2017, dt.27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore“
- Ligji nr. 9975„Per Taksat Kombetare“ i ndryshuar.
- Ligji nr. 8438 dt 28.12.1998 “Per Tatimin mbi te Ardhurat“,i ndryshuar.
- Ligji nr. 109, datë 30.11.2017,”Per Buxhetin e vitit 2018”
- Ligji nr. 107 /2014”Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit ”i ndryshuar
- Ligji nr. 9936 i dt. 26.06.2008 “Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne RSH“i ndryshuar.
- Ligji nr 5 /2016 “Per Shpalljen e Moratoriumit ne Republiken e Shqiperise“.
- Ligji nr. 10465 dt 29.09.2011“Per Sherbimin Veterinar ne Republiken e Shqiperise“i ndryshuar.
- Ligji nr 10/2016 „Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin 8308 i dt 18.03.1998“Per Transportin Rrugor“ i ndryshuar .
- Ligji nr. 152/ 2015 „“Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri“
- Ligji nr 9920 dt 19.05.2008 „Per procedurat Tatimore ne R.SH.“ te ndryshuar me ligjin nr. 164\2014.
- Ligji nr. 10463 dt 22.09.2011“Per menaxhimin e integruar te Mbetjeve Urbane“, i ndryshuar.
- Ligji nr. 8308 dt 18.03.1998 “Per Transportin Rrugor“,i ndryshuar.
- Ligji nr. 10279 dt 20.05.2010“Per Kundravajtjet administrative“.
- Ligji nr 10296 dt 08.07.2010“Per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin“.i ndryshuar.
- Ligji nr.10081, datë 23.2.2009 " Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar
- Ligji nr.10304, datë 15.7.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë"
- Ligji nr.8378, dt.22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligji nr.24/2017 " Për Administrimin e Ujitjes dhe Kullimit", miratuar me dt.09.03.2017.
- Ligji nr.106/2017 " Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632, datë.30.10.2006, "Për Sistemin e Taksave Vendore", të ndryshuar.

Vendime dhe udhëzime:

- VKM 783 dt 10.11.2011"Per procedurat e ndarjes se te ardhurave te takses vjetore te mjeteve te perdorura ne njesite e qeverisjes vendore",i ndryshuar.
- VKM nr 408 dt 13.05.2015"Per miratimin e zhvillimit te territorit ", I ndryshuar,
- Udhezimin e Ministrise se Financave nr 2 i dt 06.02.2012 „"Per Procedurat Standarte te Zbatimit te Buxhetit"i ndryshuar.
- VKM nr 433 dt 08.06.2016,"Per transferimin ne pronesi te bashkive te pyjeve dhe te kullotave publike sipas listave te inventarit".
- VKM nr 438 dt 08.06.2016 „Per Kriteret dhe rregullat e shfrytezimit te Pyjeve dhe te shitjes se materialit drusor e te prodhimeve te tjera pyjore e jopyjore.
- Udhezimi nr 01 i date 09.06.2016 ,Per rregullat dhe proçedurat e kerkimit te shqyrtimit e miratimit te kerkesave per dhenien ne perdorim te fondit pyjor e kullosor e publik".
- Udhezim nr 2 i dt 20.07.2016"Per kriteret teknike te klasifikimit te kullotave,dhe livadheve te procedurave per dhenien e tyre per kullotje dhe kositje bari"
- Udhezimin nr 5627 dt 18.11.2016"Per percaktimin e kritereve, rregullave dhe dokumentacionit per leshimin e licencave dhe certifikatave per ushtrimin e veprimtarise ne Transportin Rrugor te udhetarve brenda vendit",
- VKM 285 dt 27.06.2002"Per tarifat e sherbimeve qe kryen policia e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimit ndaj shtetasve dhe personave,juridike fizike e vendas te huaj.
- VKM 707,datë 12.10.2016 'Per Tarifen e sherbimit te mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimit te ofruara nga bashkite e paisura me stacione te ketij sherbimi,ne territorin e bashkive qe nuk kane stacione sherbimi te MZSH.
- Vendim nr 1064 i dt 22.12.2010"Per percaktimin e tarifave ne sektorin e pyjeve dhe te kullotave" .
- Udhezim nr 1 dt 09.06.2016,"Per rregullat procedurat e kerkimit te shqyrtimit te miratimit te kerkesave per dhenien ne perdorim te fondit pyjor dhe kullosor publik".
- VKM 970 dt 02.12.2015"Per Percaktimin e Proçedurave dhe te kushteve per dhenien e licencave per tregtimin e naftes bruto dhe te nenprodukteve te saj " i ndryshuar.
- VKM 1096 dt 28.12.2015"Per Miratimin e rregullave, kushteve dhe procedurave per perdorimin dhe menaxhimin e hapesires publike",
- VKM 54,datë 05.02.2014 „Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar .
- Udhezimi nr.30,datë 27.12.2011,"Per Menaxhimin e Aktiveve ne Njesite e Sektorit Publik"i ndryshuar.
- Shkresës së Ministrit të Financave nr.17905/1, dt.27.12.2016 "Për miratimin e ndryshimeve dhe shtesat në tarifat e pagesave për licenca/çertifikata.
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.7, datë 4.01.2012, "Për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare", i ndryshuar.

PËRMBAJTJE

Kapitulli I: Taksat vendore

I.1 Taksa mbi pasurinë e paluajtshme.....5
a- Taksa mbi ndërtesat.....6
b- Taksa mbi tokën bujqësore 7
c- Taksa mbi truallin 8
I.2.Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja 8
I.3. Taksa e fjetjes në hotel.....10
I.4. Taksa e tabelës 11
I.5. Tatim i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël 12
1.6.Taksa vendore mbi të ardhurat vetjake.....13
1.7.Të ardhura nga taksa kombëtare.....13
a-Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.....13
b- Taksa vjetore e mjeteve të përdorura.....14
c- Të ardhura pjesore nga taksa e rentës minerare.....15

Kapitulli II: Tarifat Vendore

II.1 Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave dhe tarifa e shërbimeve publike.....16
II.2 Tarifa për shërbimit administrativ të Bashkise Malesi e Madhe.....19
II.3 Tarifa e parkimit të automjeteve 19
II.4 Tarifa e Sherbimit Pyjor.....20
II.5 Tarifa të Sektorit të Kontrollit dhe te Zhvillimit Urbanistik e Pronave.....22
II.6 Tarifa të Agjensise P M N ZH 23
II.7 Tarifa të Sektorit për shërbimeve Veteriner 23
II.8 Tarifa e përkohshme për linjat ajrore dhe nëntokësore (tel., energji, TV kabllor, Internet).....24
II.9 Tarifa e Zënies së Hapësires Publike 24
II.10 Tarifa vjetore e mirëmbajtes së infrastrukturës ujitje-kullim dhe tarifa e shërbimit të ujitje....26
II.11 Tarifa e Shërbimit në Fushën e Transportit 26
II.12.Tarifa e autorizimit për qarkullim në qytet.....28
II.13 Tarifa për Dhënie Liçence për Tregtim të naftes bruto dhe nënprodukteve të saj.....28
II.14. Të ardhura nga dhënia me qera e aseteve në pronësi ose në përdorim.....29

Kapitulli III: Gjobat

III.1 Llojet dhe nivelet e gjobave për shkeljet dhe kundravajtjet administrative.....30
III.2 Gjoba për mosshlyerje në afat të detyrimit 32

Kapitulli IV: LEHTËSIRA FISKALE

a.Përjashtime nga pagesa e Tarifes Familjare.....34
b.Kategoritë e përjashtuar nga pagesa e tarifës.....34

Kapitulli V: ANKIMI

a.Procedura e ankimit.....35

- **Lista e tabelave:**

Tabelë 1. Nivelet e taksës së ndërtesës sipas kategorive.....6
Tabelë 2. Nivelet e taksës mbi tokën bujqësore.....7
Tabelë 3. Nivelet e taksës mbi truallin 8
Tabelë 4. Nivelet e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja 9
Tabelë 5. Nivelet e taksës së fjetjes në hotel 11
Tabelë 6. Nivelet e taksës së tabelës për qëllime identifikimi 12
Tabelë 7. Nivelet e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël 13
Tabelë 8. Nivelet e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë 15
Tabelë 9. Nivelet e tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave si dhe tarifës së shërbimeve publike për kategorinë *"Familje* 17
Tabelë 10. Nivelet e tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave si dhe tarifës së shërbimeve publike për kategorinë për *"Bizneset"*..... 18
Tabelë 11. Nivelet e tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave si dhe tarifës së shërbimeve publike për kategorinë *"Institucione"*.....19
Tabelë 12. Nivelet e tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave si dhe tarifës së shërbimeve publike për "Per Subjektet e Ndertimit"..... 19
Tabelë 13. Nivelet e tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave si dhe tarifës së shërbimeve publike "" Subjektet e Transportit".....19
Tabelë 14. Nivelet e tarifës së "Sherbimeve Administrative".....20
Tabelë 15. Nivelet e tarifës së "Parkimin e Automjeteve.....21
Tabela 16. Niveli i të ardhurave nga Shërbimi pyjor.....22
Tabelë 16. Nivelet e tarifes per "Kontrollin e Zhvillimit te Territorit".....23
Tabelë 17. Nivelet e tarifës per leje dhe shërbim veteriner 24
Tabelë 18. Nivelet e tarifës se perkohshme per linjat ajrore dhe nentokesore 25
Tabelë 19. Nivelet e tarifës për zënie hapësirë publike për qëllime biznesi 26
Tabelë 20. Nivelet e tarifës për shërbimin e Ujitjes dhe kullimit 27
Tabelë 21. Nivelet e tarifës sherbimin ne fushen e Transportit.....28
Tabelë 22. Tarifa e autorizimit për qarkullim në qytet.....29
Tabelë 23. Nivelet e tarifave për dhënie licence për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj.....30
Tabelë 24. Niveli i gjobave për për kundravajtje apo shkeljeve sipas llojeve 31
Tabelë 25. Niveli i gjobave për mosshlyerje te detyrimeve tatimore (taksa e tarifa).....34

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALËSI E MADHE

Kapitulli 1: Taksat Vendore

Ky kapitull trajton taksat vendore duke u nisur nga elementët: - Lloji, niveli i takses, baza e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kushtet lehtësuese, përjashtimet nga pagesa e taksës, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve .

I.1 Taksa mbi pasuritë e paluajtshme.

Baza Ligjore: Ligji nr.142/2015, datë 17.12.2015 "Për disa ndryshim edhe shtesa në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar,neni 4. Ligji nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", neni 11 pika 2/a, neni 12 pika 5, Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore",neni 9,20,21.

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive.

Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie.

Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i pasurisë se paluajtshme (ndërtesë, truall, tokë bujqësore) bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së pasurisë, pranë bashkisë ku ndodhet pasuria. Këshilli i Bashkisë në rastet të mungesës së dokumentacionit ligjor ngre Komisionin e Verifikimit të Pasurive të Paluajtshme, ku nëpërmjet tij vlerëson sipërfaqen që do jetë e taksueshme. Për taksën e pasurisë së paluajtshme, këshilli bashkiak vendos nivelin e taksës në kufijtë plus 30 % dhe minus 30 % të nivelit tregues të taksës për kategorinë përkatëse.

Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, për efekt të pagimit të detyrimit tatimor, kur prona nuk është e regjistruar në ZRPP, njeh si dokumentacion:
a) Vendimet e komisionit të kthimit dhe kompesimit të pronës
b) Vendimet e privatizimit
c) Dokumenta të tjera të lëshuara nga organet përkatëse në përputhje me legjislacionin përkatës

Në taksën mbi pasuritë e paluajtshme përfshihen:

- Taksa mbi ndërtesën
- Taksa mbi tokën bujqësore
- Taksa mbi truallin

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE

a- Taksa mbi ndërtesën

Baza ligjore: Ligji nr.9632,datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore",neni 22 dhe Aneksi I shënimi II, Ligji nr.142/2015, datë 17.12.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006," Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar, neni 8.

Baza e taksueshme është sipërfaqja e ndërtimit në metër katrorë e ndërtesës ose e pjesës së saj mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat.

- Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori minimale të bazës për taksën mbi ndërtesën janë si më poshtë vijon:

Tabelë 1. ndryshuar

Nr.	KATEGORITË E NDËRTESAVE	NIVELI I TAKSËS (lekë/m²/vit)	NIVELI I TAKSËS (lekë/m²/vit)
I	**Ndërtesa banimi**	**Nj.A Koplik**	**Nj.A të tjera**
	-ndërtuar para 1993-shit	5	2.5
	-ndërtuar gjatë dhe pas 1993-shit	6	3
II	II. Ndërtesa të tjera	**Nj.A Koplik**	**Nj.A të tjera**
	-për tregti dhe shërbime	200	100
	Të tjera	40	20
	Ndërtesa që përdoren për veprimtari prodhuese e të ngjashme me to	100	50
III	Ndërtesa në pronësi apo në përdorim në territore të miratuara si fshatra turistike	400	200

Tatimpaguesit që kanë në pronësi më shumë se një banesë, për ndërtesën ku kanë banimin e zakonshëm paguajnë taksën e ndërtesës, sipas tabelës, ndërsa për të gjitha shtëpitë e tjera, taksa e ndërtesës është sa dyfishi i taksës së ndërtesës, që zbatohet në zonën ku ndodhet kjo ndërtesë.(Ligji 181/2013 datë 28.12.2013 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632,datë 30.10.2008 "Për sistemi e taksave vendore", të ndryshuar.

Për ndërtesat që janë në pronësi të shoqërive të ndërtimit,të destinuara për shitje,por që janë ende të pashitura,taksa do të vendoset sipas destinacionit të përdorimit të ambientit të ndërtesës.Ambientet e hipotekuara si:

-aparatamente banimi do t'u nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë "Ndërtesa banimi"

-Ndërtesë biznesi do ti nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë "Ndërtesa të tjera për tregti e shërbime" ;

Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i nderteses bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së ndërtesës pranë bashkisë.

- **Përjashtohen nga pagesa e taksës së ndërtesës:**

a) Pronat e shtetit dhe të njësive vendore që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
b) Ndërtesat e banimit që shfrytëzohen nga qiramarrës me qira të paliberalizuar;
c) Ndërtesat që shfrytëzohen nga komunitetet fetare;
d) Pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqerive shteterore.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës : Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi ndërtesat bashkë me nënkategorizimet është Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Malesi e Madhe si dhe Zyrat e Taksave pranë Njësive Administrative.

b- Taksa mbi tokën bujqësore

Baza ligjore: Ligji nr.9632,datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", neni 23 "Taksa mbi token bujqësore", ANEKSI 2, i ndryshuar me Ligjin nr.142/2015 datë 17.12.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.9632",Ligji nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", neni 11 pika 2/a.

Përkufizimi: ***"Tokë bujqësore"*** është toka e përcaktuar si e tillë në rregjistrin e zyrave të rregjistrimit të pasurive.

Baza e taksës: Është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi apo në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë.

(*dokumentet e pronësisë, aktit të pronësisë, çertifikatës së regjistrimit të tokës*).

Niveli i taksës së tokës bujqësore: Niveli i taksës mbi pasuritë e paluajtshme-tokë bujqësore caktohet në lekë për hektar. Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori janë si vijon:

Tabelë 2.

Kategoria e tokes.	Bashkia Koplik lek/ha/vit	Nj.Administ Gruemire lek/ha/vit	Nj.Administ Kastrat lek/ha/vit	Nj.Administ Qender lek/ha/vit	Nj.Administ Shkrel lek/ha/vit	Nj.Administ Kelmend lek/ha/vit
I	--	--	--	-	--	--
II	--	--	--	-	--	--
III	--	--	--	-	--	--
IV	1000	--	1000	-	--	--
V	--	900	900	900	--	--
VI	--	800	800	800	800	--
VII-X	--	700	--	700	700	700

Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së tokës bujqësore, pranë bashkisë ku ndodhet toka.

Detyrimi për pagesë të taksës: Detyrimi për pagesën e taksës mbi tokën bujqësore është vjetor. Detyrimi llogaritet nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore si shumëzim i nivelittë taksës me bazën e tatueshme.

Përjashtime nga pagimi i taksës: ***Përjashtohen nga taksa*** tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.

Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës: Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi token bujqësore është Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Malësi e Madhe si dhe zyrat e taksave pranë Njësive Administrative.

Klasifikimi sipas kategorive te tokës bujqësore bëhet nga strukturat e Ministrise se Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit te Ujrave.

c- Taksa mbi truallin (Jo hapësirë Publike).

Baza ligjore: Ligji 142/2015, date 21.12.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.9632, 30.12.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar neni 23/1 , ANEKSI 2.1. Ligji nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", neni 11 pika 2/a.

Baza e taksës: Baza e taksës mbi truallin është *sipërfaqja e truallit në metër katror*, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë.

Niveli i taksës mbi truallin: Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror. Për çdo kategori minimale të truallit, këshilli bashkiak mund të miratojë nënkategorizime.

- Niveli i taksës mbi truallin paraqitet si më poshtë:

Tabelë 3.

Lloji taksës	Vlera e taksës në lekë/m2/vit për qëllime banimi nga individët	Vlera e taksës në lekë/m2/vit për qëllime biznesi
A. Taksë truallі	0,14 lekë/m^2	12 lekë/m^2

Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim,pranë bashkisë.

Detyrimi për pagesë të taksës: Detyrimi për pagesën e taksës mbi truallin është vjetor. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i *nivelit të taksës me bazën e tatueshme*.

Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës:Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi truallin për qëllime biznesi është Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Malësi e Madhe si dhe zyrat e taksave pranë Njësive Administrative.

I.2 Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja

Baza ligjore: Ligji 9632,datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", neni 27,i ndryshuar me Ligjin Nr.142/2015, datë 17.12.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore"", të ndryshuar,neni 14, Ligjin 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", neni 46. Ligji nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", neni 11 pika 2/b,Ligji nr.106/2017 datë 30.11.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar,neni 7.

Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet ose vlera ne leke e çmimit te shitjes per m2 te investimit te ri.Klasifikimi si investim i ri dhe vlerat përkatëse përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

Nivelet e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja: Nivelet e kësaj takse janë të

paraqitura në poshtë si vijon:

Tabelë 4.

Llojet e ndërtimeve dhe investimeve	**Niveli i taksës**
	Në përqindje
I. Në rastin e ndërtimeve për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik, taksa e ndikimit në infrastrukturë është në masën 4 për qind deri 8 për qind të çmimit të shitjes për metër katror. Baza e taksës është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së njësive të shërbimit apo ndërtesave për qëllime banimi. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave", që miratohet çdo vit.	**4%**
2. Në rastin e ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit dhe është 1 deri në 3 për qind e kësaj vlere.	**3%**
3. Për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0,1 për qind e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit.	**0,1 %**
4. Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit.	**0,5 %**

Nëse objekti, për të cilin do të bëhet investimi shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie ose kur objekti ndikon në infrastrukturen e një bashkie tjetër, të ardhurat nga taksa ndahen proporcionalisht ndërmjet tyre, në perputhje me raportet përkatëse të shtrirjes së objektit dhe të ndikimit të investimit në infrastrukturën e secilës bashki.

Baza e taksës(për pikën 1): Vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së njësive të shërbimit apo ndërtesave për qëllime banimi. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave", që miratohet çdo vit.

Baza e taksës(për pikën 2,3,4):Niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit.

Detyrimi për pagesën e taksës: Detyrimi për taksën i takon investitorit. Përllogaritja e detyrimit nga

taksa do të bëhet, duke aplikuar përqindjet përkatëse sipas kategorisë, ndaj vlerës së investimit për sipërfaqe respektive. E ardhura nga taksa për çdo rast mblidhet nga organi që lëshon lejen e ndërtimit dhe arkëtohet, për çdo rast, për llogari të Bashkisë që mbulon territorin ku do të bëhet investimi. Në rastet kur investitor është Bashkia, kjo taksë nuk aplikohet.

Përjashtime nga pagimi i taksës: Përjashtohet nga pagesa e kësaj takse, investimet e kryera për ndërtimin e strukturave akomuduese "Hotel/Resort me pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin përkatës për fushën e turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name".

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës: Struktura e ngarkuar për llogaritjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja është Sektori i Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, e cila përcjell informacionin tek Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore. Të gjitha subjektet ndërtuese do të tërheqin lejen e ndërtimit pranë Bashkisë Malësi e Madhe, vetëm pasi të kenë paguar taksën e ndikimit në infrastrukture pranë Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore pranë bashkisë Malësi e Madhe.

I.3 Taksa e fjetjes në hotel

Baza ligjore: Ligjin 142/2015, datë 17.12.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006,"Për sistemin e taksave vendore"të ndryshuar, neni 26 , ANEKSI 8.

Përkufizimi: Strukturat akomoduese do të përfshijnë kategoritë si më poshtë:

a)"Bujtinë"; b)"Fjetinë" (Hostel); c)"Kamping"; ç)"Hotel"; d)"Motel"; dh)"Resort"; e)"Qendër kurative"; ë)"Fjetje dhe mëngjes".

Baza e taksës: Baza e taksës së fjetejes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel.

Niveli i taksës së fjetjes në hotel: - Niveli taksës së fjetjes në hotel paraqitet si më poshtë si vijon:

Tabela 5.

Emërtimi	Nivelet e taksës
A. Hotelet 4-5 yje	**105 lekë/netë fjetje**
B. Bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin	**35 lekë/netë fjetje**

Për Sektorin e Taksave njihet si tatimpagues pronari i hotelit ose sipas rastit personi që ka të regjistruar aktivitetin dhe likujdimi i kësaj takse bëhet brenda datës 5 të muajit pasardhës.

Detyrimi për pagesën e taksës së fjetejes në hotel dhe kështet e pagimit: Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia, për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel. Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet hoteli. Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes dhe mbi të vlera e taksës.

Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës: Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së fjetjes në

hotel është Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Malësi e Madhe si dhe zyrat e taksave pranë Njësive Administrative.

I.4 Taksa e tabelës

Baza ligjore: Ligji 9632, date 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar me Ligjin 142/2015,datë 17.12.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" ,neni 15 "Taksa e tabelës" dhe ANEKSI 7 .

Tabelë 5. Nivelet e taksës së tabelës për qëllime identifikimi Ndryshuar

1) Tabelë për qëllime identifikimi:	**Njësia**	**Shkalla tatimore**	
		Nj.A Koplik	***Nj.A të tjera***
1)Tabelë për qëllime identifikimi, deri në 2 metra katror, të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve. Në të tilla tabela vendoset emri dhe/ose lloji i aktivitetit të kompanisë.	Lekë/ vit	**0**	**0**
a) Tabelë për qëllime identifikimi mbi 2 metra katror, të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve. Në të tilla tabela vendoset emri dhe/ose lloji i aktivitetit të kompanisë.	Lekë/m^2	**45 000**	**45 000**
b) Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti në formën e përmasat e tabelave të sinjalistikës për orientim.	Lekë/vit	**120**	**120**
2) Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme dhe e palëvizshme:	**Njësia**	**Shkalla tatimore**	
		Nj.A Koplik	***Nj.A të tjera***
a) Tabelë e thjeshtë	lekë/ m^2/vit	**13 500**	**13 500**
b) Tabelë elektronike	lekë/ m^2/vit	**27 000**	**27 000**
3) Tabele në funksion te ekspozimeve te ndryshme te hapura (panaire,spektakle, stenda reklamuese, banderola etj)	lekë/ m^2/dite	**1000**	

Struktura e ngarkuar për evidentimin dhe kontrollin: Struktura e ngarkuar për evidentimin dhe kontrollin është Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor në bashkëpunim me Policinë Bashkiake.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së tabelës : Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së tabelës bashkë me nënkategorizimet është Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Malësi e Madhe si dhe zyrat e taksave pranë Njësive Administrative.

I.5 Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.

Baza Ligjore: Ligji 142/2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006,"Për sistemin e taksave vendore",neni 5 dhe 6, Ligji nr.9632, 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, neni 10, 11,15, 17 dhe 18,ligji 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore",neni 11.

Baza e taksës/tatimit: Kështet e parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për vitin vijues, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) milionë lekë, llogariten në bazë të të dhënave të deklaratës tatimore të një viti.

Niveli i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël: Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, paraqitet si më poshtë vijon :

- Niveli i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël paraqitet si më poshtë:

Tabelë 7.

Shkalla tatimore	Njësia	Shkalla tatimore	
		Nj.A Koplik	*Nj.A të tjera*
A. Me qarkullim vjetor nga 0 – 5.000.000 lekë	lekë/vit	0	0
B. Me qarkullim vjetor nga 5.000.001 – 8.000.000 lekë	lekë/vit	5 % e fitimit	5 % e fitimit

Detyrimi për pagesë të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël: Tatimpaguesi parapaguan, në llogarinë e organeve tatimore ose në Postën Shqiptare, kështet tremujore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, të biznesit të vogël, 20 prill, për muajt: janar, shkurt e mars; 20 korrik, për muajt: prill, maj e qershor, 20 tetor për muajt: korrik, gusht e shtator; dhe 20 dhjetor, për muajt: tetor, nëntor dhe dhjetor.

Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet drejtorive rajonale tatimore, është e ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimii ii thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.

Administrata Tatimore Qendrore transferon të ardhurat nga tatami i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël në llogari të bashkive ose të komunave, ku ka vendndodhjen biznesi i taksueshëm, 10 të muajit pasardhës, kur janë arkëtuar tatimet dhe për shërbimin që kryen merr një komision, i cili është në masën 1 për qind dhe derdhet në llogari të Administratës Tatimore Qendrore.

Struktura përgjegjëse për kryerjen e akt-rekomandimeve: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore është përgjegjësi për rekomandimet me Drejtorinë Rajonale Tatimore, Shkoder.

I.7. Të ardhura nga taksat e ndara (taksa kombëtare).

Baza ligjore: Ligji nr.9632,datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore",neni 32 i ndryshuar,Ligji nr.68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore",neni 11,pika ë,neni 25.

a-Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme
b-Taksa vjetore e mjeteve të përdorura
c-Të ardhura pjesore nga taksa e rentës minerare
ç- Të ardhura nga taksa vendore mbi të ardhurat personale

I.7. a- Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

Baza ligjore: Ligji 9632,datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore",neni 28 "Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme" dhe ANEKSI 3 (ndryshuar me ligjin nr.142/2015).

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to. Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme , para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror të bazës së taksës. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

Baza e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme (tokë bujqësore. truall) është vlera e shitjes së tyre.

Niveli i taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme (tokë bujqësore. truall) caktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës ***është 2 për qind***. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

Niveli i taksës *mbi kalimin e së drejtës së pronësisë* caktohet në lek për m^2 të bazës së taksës.

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset të paguhet në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi të,në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

- Niveli i taksës *mbi kalimin e së drejtës së pronësisë* paraqitet si më poshtë:

Tabela 9.

Shkalla tatimore	Njësia	Shkalla Tatimore
A. Ndërtesa banimi	lekë/ m²	100
B. Ndërtesa të tjera për tregti dhe shërbime	lekë/ m²	300
C. Ndërtesa të tjera	lekë/ m²	200

Detyrimi për pagesën: Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Përjashtime nga pagimi i taksës: Përjashtohen nga pagimi i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme:

a) Enti Kombëtar i Banesave, Ministria e Financave dhe organet e qeverisjes qendrore e vendore;

b) Personat, të cilët janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat vetjake, në mbështetje të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", me ndryshimet përkatëse;

c) Subjektet, që dhurojnë pasuri të paluajtshme, kur përfitues të drejtpërdrejtë janë:

i) Institucionet dhe entet shtetërore e publike, qëndrore e vendore.

ii) Bashkësitë fetare ose organizatat jofitimprurëse, kur dhurimi lidhet me atë pjesë të veprimtarisë së tyre pa qëllim fitimi.

Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës: Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë është Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në rolin e agjentit tatimor, të cilat përfitojnë **3%** të shumës së arkëtuar, dhe diferencën e derdhin për llogari të buxhetit të bashkisë (**97%**), në territorin e së cilës ndodhet pasuria, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës

I.7. b- Taksa vjetore e mjeteve të përdorura

ndryshuar 25%

Baza ligjore: VKM nr.783, date:10.11.2011"Për Procedurat e ndarjes së të ardhurave të Takses Vjetore të mjeteve të përdorura ne njësite e Qeverisjes Vendore", i ndryshuar. Ligji nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", neni 25 pika 2/b.

Bazaa e taksueshme: Baza e taksës së mjeteve të përdorura është lloji i mjetit të transportit rrugor.

Niveli i taksës: Niveli i taksës shprehet në një kuotë të caktuar, sipas llojit të mjetit.

Detyrimi për pagesën: Detyrimi për pagimin e taksës së mjeteve të përdorura i takon pronarit të mjetit.E ardhura nga taksa, për çdo rast, mblidhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, drejtoritë rajonale, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të

detyrueshëm të mjetit. **25 %** e të ardhurave vjetore nga kjo taksë i kalojnë buxhetit të qeverisjes vendore.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës: Struktura e mbledhjes së kësaj takse është Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit.

I.7. c- Të ardhura pjesore nga taksa e rentës minerare

Baza ligjore: Ligji nr. 10304, datë 15.7.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë"; neni 40. Ligji nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", neni 25 pika 2/c.

Baza e taksës: Janë burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka çdo person fizik apo juridik, në çastin kur ai shet produktin e tij.

Detyrimi për pagesën e taksës: Çdo person fizik apo juridik, që është i liçencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës: Struktura e mbledhjes e kësaj takse është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Degët e doganave në rrethe ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit, **(5%)** e të ardhurave të realizuara nga kjo taksë i kalon përkatësisht Bashkisë Malësi e Madhe,në llogarinë e degës së thesarit.

1.7 ç - Taksa vendore mbi të ardhurat personale.

Baza ligjore: Ligji nr.68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", neni 11 pika 2/e, 25 pika 2/ç.

Taksa vendore mbi të ardhurat personale hyn në kategorinë e "taksave të ndara". Është taksë kombëtare që një përqindje të saj e marrin njësitë e vetëqeverisjes vendore për të ardhurat që realizohen në juridiksionin e tyre. Bashkisë Malësi e Madhe i kalon një përqindje prej **(2%)** e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale.

Kapitulli II: Tarifat vendore.

Ky kapitull trajton tarifat vendore në mënyrë nominale duke u nisur nga elementët: - Llojit të shërbimit, nivelit te tarifes bazuar ne koston e sherbimit, baza e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

II.1 Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave si dhe tarifa e ndriçimit dhe gjelbërimit

Baza ligjore: Ligji 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 9, pika1.3 b. Ligji nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", neni 14 pika 2 dhe 5/b.

Tarifat e pastrimit dhe sherbimeve publike jane caktuar duke u bazuar ne studimin e kryer nga bashkia Malesi e Madhe "Plani Lokal për Manaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane në Bashkinë Malësi e Madhe".

Përkufizime:

a-Tarifës së pastrimit i nënshtrohen të gjithë familjet, personat juridikë ose fizikë, vendas ose të huaj, që ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Malësi e Madhe dhe njësive të saj administrative.

b-Tarifa për ndriçimin dhe gjelberimin është detyrim i çdo taksapaguesi i cili përfiton shërbime të tilla si ndriçim, gjelbërim, etj, përveç pastrimit.

Në rastin kur subjekti krijohet(regjistrohet) apo mbyllet gjatë vitit kalendarik, detyrimi për tarifat e pastrimit dhe shërbimeve llogaritet dhe arkëtohet proporcionalisht me kohën aktive të ushtrimit të aktivitetit. Afati i pagesës së këtyre detyrimeve është data 20 qershor e vitit aktual kalendarik.

Baza e tarifës: është vlera në lekë sipas kategorive e cila duhet të mbulojë koston e shërbimit.

Detyrimi për pagesën: Detyrimi për tarifën është vjetor.

Nivelet e tarifës së pastrimit dhe tarifës së ndriçimit dhe gjelberimit:

Për kategoritë dhe nënkategoritë familje, person juridik apo fizik si dhe ne institucione janë të paraqitura në tabelat si më poshtë::

Tabelë 9. Nivelet e tarifës së pastrimit dhe largimit te mbeturinave si dhe tarifës së ndriçimit dhe gjelberimit për kategorinë *"Familje"*

II.1 - a) Tarifat për familjet	Njësia	Lloji i tarifës		
		Tarifë pastrimi	*Tarife Gjelberimi*	*Tarifë ndriçimi*
Njësia Admistrative Koplik (Qyteti),	lekë/vit/familje	2500	100	200
Bajze (Qytet), Hot(dogane), Tamare (Qender), Razma, Dedaj.	lekë/vit/familje	1700	100	200
Njësitë administrative Kastrat,Shkrel,Gruemire	lekë/vit/familje	1700	0	0
Njësitë administrative Qender, Kelmend	lekë/vit/familje	1300	0	0

(Me ende)

Tabelë 10. Tarifa e pastrimit dhe largimit te mbeturinave si dhe tarifa e ndricimi dhe gjelberimit për kategorinë " *Biznes* "

Nr	Kategorite	0-5 mln/vit	5-8 mln/vit	Mbi 8 mln/vit
I	***NJESI TREGTIMI***			
1.	Tregtim mishi,peshku etj te ngjashme me to.	7.000	10.000	50.000
2.	Tregtim materiale hidrosanitare,elektroshtepiake etj	7.000	10.000	50.000
3.	Tregtim bulmet, Fruta, perime, artikuj ushqimore, industrial etj dhe tengjashme me to.	6.000	10.000	50.000
4.	Njesi shitje te ndryshme.	5.000	10.000	30.000
5.	Bar kafe, fast food etj te ngjashme me to.	7.000	10.000	50.000
6.	Bar-Restorante	20.000	30.000	45.000
7.	Restorant per dasma (sezonale)	50.000	70.000	70.000
8.	Kafe internet, lojëra fati, qendra interneti, etj te njashme. me	6.000	10.000	25.000
9.	Njesi tregtimi lendesh djegese, hidrokarbure, karburante etj	6000	15.000	35.000
10.	Shitje produktesh farmaceutike ,farmaci bujqeore etj	8.000	10.000	30.000
11.	Markete	20.000	30.000	40.000
12.	Supermarkete	30.000	35.000	50.000
13.	Magazina	10.000	20.000	50.000
II.2	**NJESI PRODHIMI.PERPUNIMI ETJ**			
	Perpunim bime medicinale, duralumini, metalesh, druri,etj	15.000	35.000	80.000
	Prodhim tulla, perpunim guri, tjegulla, blloqe betoni, furra gelqereje, etj	8.000	20.000	50.000
	Prodhime ushqimore, buke, embelsirash mishi, peshku,	7.000	15.000	25.000
	Territore per therrjen e kafshëve etj. te ngjashme me to.	20.000	35.000	50.000
	Karriera dhe inerte	20.000	100.000	100.000
	Pike Karburanti	0	35.000	70.000
II.3	***NJESI SHERBIMI***			
	Riparimi i artikujve elektro-shtepiake,celulare,etj. ngjashme me to.	6.000	15.000	25.000
	Sherbime servisi, agjensi kembimi valute, agjensi turizmi, agjensidoganore,sigurimesh,funerale, etj te ngjashme me to.	8.000	15.000	25.000
	Sallon bukurie, sherbime (zyra)kredidhenie, sallat e lojrave te fatit, pika bastesh sportive, etj.	7.000	17.000	25.000
	Hotele, motele, fjetina, bujtina,kampingje etj.	20.000	35.000	50.000
	Njësi shërbimi si: marangoz, rrobaqepës,fotograf,këpucaretj.	7.000	10.000	25.000
	Komplekse sportive, palestra,salla fitnesi, pishina, etj	8.000	10.000	25.000
	Njesi sherbimi internet, tv.kabllor te ngjashme me to.	10.000	30.000	50.000
	Bankat e Nivelit te dyte.	0	0	80.000
	Shoqata, Fondacione, Organizata, Subjekte Politike.	8.000	15.000	25.000
	Ente te ndryshme shteterore	0	0	50.000
II.4	***PROFESIONE TE LIRA***			
	Avokat, noter,mjek, mjeku- laborant, stomatologu,veterinar, ekonomist kontabël etj, te ngjashme me to.	10.000	15.000	20.000
	Institucionet jopublike te edukimit(cerdhe,kopshte,shkolla etj	6.000	10.000	25.000
II.5	***AMBULANT***			

	Subjekte qe nuk kane një vendndodhje fikse, taksi, tregtia ambulante ne tregje publike.	4.000	7.000	0

Tabelë 11. Nivelet e tarifës së pastrimit dhe largimit te mbeturinave si dhe tarifës së ndriçimit dhe gjelberimit për kategorinë "*Institucione*".

II.1 – b) Tarifat për institucionet shtetërore administrative, arsimore,kulturore, shëndetsore, sportive, etj.	**Njësia**	**Lloji i tarifës**		
		Tarifë pastrimi	***Tarife ndricimi***	***Tarife gjelbrimi***
a) Deri në 20 punonjës	lekë/vit	25.000	3.000	2.000
b) Mbi 20 punonjës -100 punonjës	lekë/vit	45.000	3.000	2.000
c) Mbi 100 punonjës	lekë/vit	50.000	3.000	2.000

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës: Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës e pastrimit, largimit të mbeturinave dhe tarifën e Shërbimeve për kategorinë "Institucione" është Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkia Malësi e Madhe

Tabelë 12. Tarifa e pastrimit dhe largimit te mbeturinave për kategorinë "*Subjektet e Ndertimit*"

Shkalla tatimore	**Njësia**	**Shkalla tatimore**	
		Nj.A Koplik	***Nj.A të tjera***
Per subjekt ndërtimi seli administrative: • **Biznes i madh**	**leke/vit**	**60.000**	**40.000**
Per subjekte ndertimi B.V & B.M: • Njesi ndertimi(per cdo kantier ndertimi,rruge, shkolla,kopshte,objekte banimi kolektive e tregtare,zyra dhe te ngjashme me to). • njesi ndertimi banesa individuale. • rikonstruksione. • rikonstruksione te banesave individuale.	**leke/kantier** **leke/kantier** **leke/kantier** **leke/kantier**	**100.000** **20.000** **50.000** **10.000**	**100.000** **20.000** **50.000** **10.000**

Tabela 13. Tarifa e pastrimit dhe largimit te mbeturinave si dhe tarifa e ndriçimit dhe gjelberimit për kategorinë "*Transport* ".

II.10	**TRANSPORTI**	**Biznesi i madh Mbi 8 milion**	**Biznesi i vogel 0-8 milion**
1.	**Transport udhetaresh (leke/ vit)**	10.000	3.000
2.	**Transport mallrash (leke/ vit)**	8.000	4.000

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës për kategorinë "biznes": Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës se pastrimit, largimit të mbeturinave dhe tarifën e shërbimeve për kategorinë "Biznes i Vogël" është Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore si dhe zyrat e taksave sipas ndarjes në tabelën 12.

II.2. Tarifa të shërbimit administrativ të Bashkisë Malësi e Madhe

Baza ligjore: Ligji 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 9, pika 1.3, Ligji nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", neni 14 pika 5/d, neni 16.

Përkufimi: *Tarifa për shërbimet administrative* është detyrim i cili duhet likujduar përpara marrjes së një shërbimi të caktuar (vërtetime, fotokopje dokumentash, njehsime me origjinalin etj.) nga administrata. Arkëtimi i këtij detyrimi bëhet pranë Arkës në Bashkinë Malësi e Madhe. Kjo e fundit e pajis me faturë individin, faturë e cila dorëzohet në zyrën apo drejtorinë përkatëse, përpara marrjes së shërbimit.

Niveli i tarifës së shërbimeve administrative: Paraqitet si më poshtë në tabelën nr.14:

Tabelë 14.

II.5– a) Tarifë për shërbime administrative në Bashkinë Malësi e Madhe	**Njësia**	**Niveli i tarifës** *Për çdo rast shërbimi*
1- Për shërbim arkivor, tërheqje dokumentash, njehsime me origjinalin,vertetime per subjektet etj.	Lekë/vërtetim	500
2- Vertetime tetjera si: ndihme ekonomike,saktesim adrese,vjetersi pune,page etj. te ngjashme me to.	Lekë/vërtetim	100

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës administrative: Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës administrative është Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Malësi e Madhe si dhe Zyrat e Taksave pranë Njësive Administrative.

I I . 3 Tarifa e parkimit të automjeteve.

Baza ligjore: Kodi rrugor ligji 8378 date.22.07.1998, "Kodi rrugor i RSH" neni 7 pika f, Ligji Nr.9632 date 30.10.2006 "Per sistemin e taksave Vendore" I ndryshuar, neni 35, pika 2. Ligji nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", neni 15 pika 1/c.

Përkufizimi: *Tarifa e parkimit të automjeteve* është detyrim i çdo individi ne vleren 50 lekë/ore/automjet.(Qyteti Bajze,Koplik).

Detyrimi për pagesën e tarifës: Kjo tarife eshte vjetore dhe paguhet nga subjektet vetem per nje vendodhje te ushtrimit te aktivitetit.

Niveli i tarifës së parkimit te automjeteve: Niveli i tarifës së parkimit te automjeteveparaqitet si më poshtë në tabelën nr.15:

Tabelë 15.

I. Tarifa shërbimi për parkimin e automjeteve	Njësia	Niveli i tarifës *Sipas çdo rasti*
1- Per Autovetura 2- Per autobuza	Lekë/orë/mjet	50 30
II-Tarifa per subjektet qe kerkojne parkim te rezervuar prane institucioneve te tyre publike ose private ne vende te miratuara nga keshilli bashkiak: a.Per autoveturat e licensuara taksi(me vende qendrimi te rezervuara) • Autovetura taxi 4+1 • Autovetura taxi 8+1 b.Per autopuzat te shoqerive te transportit (pa parkim rezervuara). • Autobuza deri ne 30 vende • Autobuza mbi 30 vende	Lekë/vit/mjet	20.000 18.000 20.000 10.000 8.000
3-Automjet transport malli 3.5 – 8 ton	Lekë/vit/mjet	3.500
4-Automjet transport malli 8 – 14 ton	Lekë/vit/mjet	4.000
5-Automjet transport malli mbi 14 ton	Lekë/vit/mjet	5.000
PARKIM I REZERVUAR.(SHESH I MIRATUAR)		
1- Për Autobusa.	Lekë/vit/mjet	35.000
2 - Taksi 4+1 të licensuara	Lekë/vit/mjet	10.000
3-Automjet për transport 8+1 të licensuara	Lekë/vit/mjet	15.000
4-Autovetura	Lekë/vit/mjet	23.000

Struktura e ngarkuar për miratimin e lejes për vendparkim të rezervuar: Struktura e ngarkuar për miratimin e lejes për vendparkim të rezervuar është Sektori I Zhvillimit Urban dhe Turizmit, për llogaritjen dhe për vjeljen e tarifës së parkimit është zyra e tatim taksave.
Struktura e ngarkuar për penalitetet: Struktura e ngarkuar për penalitetet për mos pajisje me lejë për vendparkim të rezervuar është Policia Bashkiake.

II .4 Të ardhura nga Shërbimi Pyjor.

Baza ligjore: Ligji 139\2015"Per Vetqeverisjen Vendore"neni 27 pika 5,pika 6, ligji 5\2016 "Per shpalljen e moratoriumit ne Republiken e Shqiperise",ligji 48/2016 ""Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr 9385 dt 04.05.2005 "Per Pyjet dhe sherbimin Pyjor" te ndryshuar,VKM 433 date 08.06.2016,V.K.M 438 date 08.06.2016, Udhezimi nr. 1 date 09.06.2016 "Per rregullat dhe procedurat e kerkimit te shqyrtimit e miratimit te kerkesave per dhenien ne perdorim te fondit pyjor e kullosor dhe publik", VKM nr.1064 datë 22.12.2010 "Per disa ndryshime ne vendimin nr.391 date 21.06.2006 te K.M. Per percaktimin e tarifave ne sektorin e pyjeve dhe te kullotave".

Udhezimi nr.2 date 20.07.2016"Per kriteret teknike te klasifikimit te kullotave,dhe livadheve dhe procedurave per dhenien e tyre per kullotje e kositje bari". Ligji nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", neni 14 pika 5/ë.

Tabela 16. Niveli i të ardhurave nga Shërbimi pyjor.

Nr.	Emrtiëmi i shërbimit	Njësia matjes	Tarifa shitjes per njesi.
1.	**Plotsimi i nevojave për dru zjarri të komunitetit**		
a	Lëndë punimi e mesme	m^3	3100
b	Lëndë punimi e hollë	m^3	1700
c	Dru zjarri	m^3	500
2.	**Fruta Pylli**		
a	Geshtenja	kv	500
b	Lajthi	kv	500
c	Boronica	kv	500
d	Arra	kv	500
3.	**Bimë medicinale**		
a	Herba (Sherbele)	kv	70
b	Sanza (Rrenje)	kv	70
c	Çaj mali	kv	70
d	Trumze	kv	70
e	Lisen	kv	70
4.	**Shfrytzim të kullotave**		
a	Për bagëti të trasha (Gjedhe)	kokë	800
b	Bagëti të imëta dhen etj.	kokë	200
5.	**Dhënie në përdorim**		
a	Dhënie e sip.pyjore,kullusore.	ha	1000000
b	Antena celulare 15 × 0.03 ha	ha	145000

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE

II.5 Tarifa të Sektorit të Kontrollit të Zhvillimit Urbanistik e Pronave.

Baza ligjore: Ligji 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 9, pika 1.3, germa b. VKM Nr.408, datë 13.05.2015 "Për Miratimin e Rregullores se Zhvillimit te Territorit" neni 10, pika 1, germa b,dhe neni 15, pika 1, germa f .

Nivelet e tarifës: Nivelet e tarifës për kontrollin e zhvillimit të territorit janë paraqitur si më poshtë vijon:

Tabelë 17.

II.5 Tarifa për kontrollin e zhvillimit të territorit	Njësia	Niveli i tarifës *Sipas çdo rasti*
1-Tarife aplikimi per leje zhvillimi, leje ndërtimi:		
a - për shtëpi banimi	lekë /dosje	2000
b - për nevoja biznesi	lekë /dosje	2000
1.1. Tarife për shqyrtim dokumentacioni.		
a - për shtëpi banimi	lekë /dosje	5000
b - për nevoja biznesi	lekë /dosje	8000
2-Tërheqje dokumentash të njehsuara me origjinalin:	lekë /dok	500
2.1-Te gjithe dosjes nga arkivi i sektorit	lekë /dosje	5000
3 –Tarife aplikimi per çertifikatë përdorimi:		
a - për shtëpi banimi	lekë /dosje	1000
b - për nevoja biznesi	lekë /dosje	1000
3.1.-Tarifë për shqyrtim dokumentacioni(çertifikat përdorimi)		
a - për shtëpi banimi	lekë /dosje	2000
b - për nevoja biznesi	lekë /dosje	4000
3.2.Tarifë per çertifikate përdorimi		
a - për shtëpi banimi	lekë/m^2	30
b - për nevoja biznesi	lekë/m^2	60
4-Tarife kontolli:	lekë	5000
4.1-Aktet e kontrollit piketim, kuote+-00 per objekte 1 deri 2 kate	lekë	10.000
4.2-Aktet e kontrollit piketim, kuote+-00 per objekte deri ne 3 kate	lekë	15.000
4.3-Aktet e kontrollit piketim, kuote+-00 per objekte deri ne 6 kate	lekë	25.000
4.4-Aktet e kontrollit piketim, kuote+-00 per objekte mbi 6 kate	lekë	30.000
4.5- Aktet e kontrollit piketim, kuote+-00 per bjekte industriale	lekë/nr.objekte	6000
4.6-Per objekte turistike, (kur kane me shume se nje njesi zhvillimi)	lekë	6000
4.7-Akt kontroll karabina, sistemim i jashtem objekte 1 deri ne 2 kate	lekë	8000
4.8- Akt kontroll karabina, sistemim i jashtem objekte deri ne 3 kate	lekë/çdo kat	1500
4.9- Akt kontroll karabina, sistemim i jashtem objekte mbi 3 kate	lekë	5000
4.10-Tarife per zbardhje dosje per objekte 1 deri ne 2 kate	lekë	8000
4.11- Tarife per zbardhje dosje per objekte deri ne 3 kate	lekë	15000
4.12- Tarife per zbardhje dosje per objekte mbi 3 kate		

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës : Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së shërbimeve është Sektori Zhvillimit Urban pranë Bashkisë Malësi e Madhe.

II.6 Tarifa nga Agjensia e P.M.N.Z.SH Malësi e Madhe

Baza ligjore: VKM 707 viti 2016 si dhe Ligji 152/2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri".VKM nr.285 date: 27.6.2002 "Per tarifat e sherbimeve qe kryen policia e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimit ndaj shtetasve dhe personave juridik e fizik, vendas dhe te huaj". Ligji nr.68/2017, datë 27.04.2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", neni 14 pika 5/ë.

Struktura e ngarkuar për lëshimin e Akteve dhe të pagesës : Struktura e ngarkuar për lëshimin e Akteve dhe të pagesës për tarifat e shërbimit është Sektori i M. Z.SH. prane Bashkise Malesi e Madhe.

II.7. Tarifa të Sektorit të Shërbimeve Veterinar.

Baza ligjore: Ligjit nr. 139\2015 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore", Ligji Nr.10465, date 29.09.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", Akti Normativ Nr.4 datë 16.08.2012 "Për përcaktimin e rregullave për therjen e kafshëve dhe tregtimin e mishit të tyre" neni 7, pika 2 dhe Vendimin Nr.230 datë 20.03.2013 "Për përcaktimin e funksioneve, detyrave specifike dhe standarteve të shërbimit veterinar të qeverisjes vendore", kreu IV, pika 6 dhe 7. Ligji nr.68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", neni 14 pika 5/ë.

Përkufizimi: Tarifa për shërbimet veterinare përfshin kontrollin nga ana e inspektoriatit veterinar dhe vulosjen e bagëtive.

Detyrimi për pagesë: Tarifa për shërbimet veterinare është detyrim për çdo taksapagues i cili kryen aktivitet të shitjes së mishit të çdo lloji.

Nivelet e tarifës për leje dhe shërbim veteriner : Nivelet e tarifës për leje dhe shërbim veteriner janë paraqitur si më poshtë vijon:

Tabelë 18.

Nr	KATEGORITË	NIVELI TREGUES I TARIFËS/lek
1	Vulosja e mishit dhe pajisja me raport veterinar për bagëti te trasha	200 lekë/krerë
2	Vulosja e mishit dhe pajisja me raport veterinar për bagëti te imëta	100 lekë/krerë

Struktura e ngarkuar per vjeljen e tarifës: Struktura e ngarkuar per vjeljen e tarifes te sherbimit veteriner jane inspektoret e sherbimit veterinar prane Bashkise dhe njesive administrative.

II.8. Tarifë e përkohshme për linjat ajrore dhe nëntokësore (telefoni, energji, TV kabllor, Internet).

Baza ligjore: Ligji.nr.139/2015, dt.17.12.2016 "Për vetëqeverisjen vendore",neni 35,pika 5,germa ç, ligji 68/2017, dt.27.04.2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 14 pika 5/dh.

Baza e tarifës: Baza e tarifes për linjat ajrore dhe nëntokësore është gjatësia lineare për kilometër e linjave ajrore dhe nëntokësore e cila vihet në shfrytëzim nga subjekte për qëllime biznesi. Tarifa llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit duke shumëzuar bazën e tarifes (gjatësinë lineare për kilometër) me nivelin tregues të saj.

Nivelet e tarifës: Nivelet e tarifes së përkohshme për linjat ajrore dhe nëntokësore janë paraqitur si më poshtë vijon:

Tabelë 19.

Emërtimi i shërbimeve.	**Njësia**	**Niveli i tarifës**	
		Nj.A Koplik	***Nj.A të tjera***
A. Linja ajrore (telefoni,energji,Tv. kabllor,internet)	Lekë/km/vit	***2500***	***2500***
B. Linja nëntokësore(telefoni,energji,Tv kabllor,internet).	Lekë/km/vit	***3000***	***3000***

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifes: Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifes së përkohshme për linjat ajrore dhe nëntokësore është Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Malësi e Madhe si dhe Zyrat e Taksave pranë Njësive Administrative. Per dhënien e lejes ngarkohet Sektori I Zhvillimit Urban dhe Turizmit prane Bashkise.

II.9. Tarifa e zënies së hapësirës publike.

Baza ligjore: Ligji 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore", neni 9, pika 1.3, ligji 142/2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632,datë 30.10.2006" ,neni 16, pika c Aneksi 6. VKM nr.1096 i datës 28.12.2015,ligji nr.68/2017,datë 27.04.2017"Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 14 pika 5/a, neni 15.

Baza e tarifës: Tarifa për zënien e hapësirës publike llogaritet si detyrim mujor i tatimpaguesit. Këshilli bashkiak vendos për nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e kësaj tarife si dhe mund të caktojë nivele te ndryshme të kësaj tarife, sipas nivelit të zhvillimit të veprimtarisë së biznesit në zona të ndryshme të qëndrës së banuar. Tarifa për zënien e hapësirës publike nuk zbatohet për hapësirat që nuk janë në pronësi dhe nën administrimin e pushtetit vendor.

Nivelet e tarifës: Nivelet e tarifës për zënien hapësirës publike për qëllime biznesi janë paraqitur si më poshtë vijon:

Tabelë 20.

Kategoria dhe nënkategoria Sipas llojeve të tregtimit,shërbimeve etj		Niveli tregues i tarifës/muaj Bashkia Qëndër	Niveli tregues tarifës/muaj Nj.Administrative. të tjera
1	Zënia e hapësirës publike (për qëllime biznesi, tavolina për bar dhe restorante etj.)	60 lekë/m^2	30 lekë/m^2
2	Spektakle ose panaire të ndryshme, ngritje tendash dhe mjetesh të tjera për përdorim të përkohshëm, kamping etj.	60 lekë/m^2	30 lekë/m^2
3	Për përdorime të tabelave të reklamës.	60 lekë/m^2	30 lekë/m^2
4	Për zënien e hapësirës publike për rulote dhe trailer.	60 lekë/m^2	30 lekë/m^2
5	Për zënien e hapësirës publike për restorante dhe mjedise të tjera argëtimi pranë lumejve ose liqen.	60 lekë/m^2	30 lekë/m^2
6	Për zënien e hapësirës publike për mbajtjen e materialeve të ndërtimit.	60 lekë/m^2	30 lekë/m^2
Kategoria dhe nënkategoria		**Niveli tregues i tarifës/ditor** **Bashkia Qëndër**	**Niveli tregues tarifës/ditor** **Nj.Administrative. të tjera**
7.	Për tregtim shitje ambulant (ditor)	1000 lekë	500 lekë

Shënim:*Për njësitë administrative të tjera, niveli tregues i taksës është sa ½ e nivelit tregues përkatës në njësitë administrative të përcaktuara në tabelë.*

Struktura e ngarkuar për dhënie leje dhe për vjeljen e kësaj tarife: Struktura e ngarkuar për dhënie leje për zënie të hapësirave publike, matjen dhe përllogaritjen e kësaj tarife është Sektori i Zhvillimit Urban e Turizmit dhe për vjeljen e kësaj tarife është Sektori i Taksave e Tarifave Vendore ne Bashkinë Malësi e Madhe.

Struktura e ngarkuar për penalitetet: Struktura e ngarkuar për penalitetet për mos pajisje me lejë për zënie hapësire publike është Policia Bashkiake.

II.10 Tarifa vjetore e mirëmbajtes së infrastrukturës ujitje-kullim dhe tarifa e shërbimit të ujitjes.

Baza ligjore: Ligji nr.24/2017 " Për Administrimin e Ujitjes dhe Kullimit", miratuar me dt.09.03.2017, neni 15, neni 16 pika a/b , neni 17, neni 18, neni 19,Ligji 68/2017, dt.27.04.2017 ,datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 14 pika 5/ç.

Nivelin e tarifës: Në zbatim të këtij ligji paraqesim tabelën për nivelin e tarifës vjetore të mirëmbajtes së infrastrukturës dhe shërbimit të ujitjes si më poshtë:

Tabelë 21. .

II.9– d) Kategori, nënkategori e tarifës për ujitjen dhe kullimin	Lekë	Niveli i tarifës
• Tarifa vjetore e mirëmbajtjes infrastrukturës ujitjes e kullimit.	Lekë/ dynym/vit	150
• Tarifa e shërbimit të Ujitjes	Lekë/orë/ujitje	200

Shënim: *Tarifa e mësiperme përfshin vetem fshatrat e Njësisë Administrative Gruemirë që janë pjesë e sistemit të Ujitjes. Aktualisht Bashkia Malesi e Madhe administron vetë këto shërbime përmes strukturës përkatëse (Bordi i Ujitjes dhe Kullimit).*

II.11.Tarifa e shërbimit në Fushën e Transportit

Baza ligjore: Ligji nr.8308, datë 18.03.1998 "Per transportin rrugor",i ndryshuar, neni 14 dhe 15, Ligji nr.10/2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8308, datë 18.03.1998 "Për transportin rrugor" neni 5, Udhëzimi nr.5627,datë 18.11.2016 "Për përcaktimin e kritereve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit",neni 8 pika 2, Udhëzimi nr.5628,datë 18.11.2016 "Për miratimin e rrjetit të linjave ndërqytetëse",Udhëzimi nr.5630.datë 21.11.2016 "Për kriteret e liçesimit për të kryer kontrollin dhe provën e mjeteve me motor dhe të rimorkiove të tyre, kur janë bëre një a më shumë ndryshime të karakteristikave konstruktive ose funksionale apo të sistemeve të paisjeve",Udhëzimi nr.15,datë 24.07.2007 (i ndryshuar),neni 19, shkresa e Ministrisë së Financave nr.17905/1,datë 27.12.201 "*Për ndryshimet dhe shtesat në tarifat e pagesave për licensa dhe certifikata në fushën e transportit rrugor*".

- Gjithashtu subjekti para kryerjes së kërkesës në Sektorin e Shërbimeve duhet të ketë shlyer të gjitha detyrimet tatimore pranë Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore dhe të jetë pajisur me vërtetim nga ky sektor.
- Në çdo rast kërkese nga ana e subjekteve, këta të fundit pajisen me liçencë apo autorizim nga Sektori ku përcaktohen të dhënat përkatëse.

Nivelet e tarifës për shërbimin në fushën e transportit.: Bashkia Malësi e Madhe lëshon Licensa, Certifikata dhe Autorizime kundrejt tarifave për transportin publik. Nivelet e kësaj tarife janë të paraqitura si në tabelën më poshtë vijon:

Nr 8808

Tabelë 22.

II.9– e) Kategoritë, nënkategoritë	Njësia	Niveli i tarifës (në *Afati 10 vjeçar*
I. TRANSPORT UDHËTARËSH BRENDA VENDIT		
1- Licencë për kryerjen e sherbimeve ne linje te rregullt rrethqytetëse -Çertifikatë për kryerjen e sherbimeve në linjë të rregullt rrethqytetëse	Për linje Për mjet	40.000 7.500
Kategoritë, nënkategoritë	**Njësia**	**Niveli i tarifës Afati 5 vjeçar**
2- Licencë për kryerjen e sherbimeve në linje të rregullt te specializuara -Çertifikatë për kryerjen e sherbimeve në linjë të rregullt te specializuara	Për linjë Për mjet	20.000 7.500
3- Licencë për kryerjen e sherbimeve vajtje-ardhje (lavjerres) të udhëtarëve -Çertifikatë për kryerjen e sherbimeve vajtje-ardhje (lavjerres) të udhëtarëve	Për linjë Për mjet	20.000 7.500
4- Licencë për transport udhëtarësh me taksi	Për mjet	20.000
II. TRANSPORT MALLRASH BRENDA VENDIT		**Afati 5 vjecar**
1-Licencë për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit -Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit	Për licencë Ton/kapacit	40.000 100*
2-Çertifikatë për transport mallrash brenda vendit për llogari të Vet	Ton/kapacitet	100*
4- Çertifikatë për tërheqës	Për tërheqës	7.500
III. SHËRBIME TRANSPORTI		
1- Licencë për sherbim udhëtarësh me taksi	Për licencë	15.000
IV. VEPRIMTARI TË TJERA		
1- Autorizim i përkohshëm një mujor.	Për autorizim	2.000
2- Autorizim i përkohshëm ditor.	Për autorizim	500

1500-

Licencë për Agjensi transporti mallrash + taksi 1500

Shënim:

a) Për duplikate me të njëjtën përmbajtje dhe afat vlefshmërie paguhet 30% e vlerës së plotë.

b) Për rastet e ndryshimeve në liçencë/certificate që kanë të bëjnë me elementet e përdoruesit të mjetit, fushës së operimit etj. Paguhet 30% e vleftës së plotë.

*Vlefta e dalë nga llogaritja e ton/kapacitet do të shumëzohet me pesë (afatin kohor).

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës: Ngarkohet Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Malësi e Madhe për llogaritjen dhe arkëtimin e këtyre tarifave, në bashkëpunim me Policinë Bashkiake.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALËSI E MADHE

I.12. Tarifa e autorizimit për qarkullim në qytet.

Baza ligjore: Ligji nr.10081,datë 23.02.2009 "Për licencat,autorizime dhe lejet në Republikën e Shqipërisë"

Bashkia Malësi e Madhe lëshon Autorizime kundrejt tarifave, si më poshtë vijon:

Tabela 23.

Nr.	Emërtimi	Njësia	Tarifa në lekë
1.	Autorizim për lëvizje kundër sinjal rrugor "Ndalim qarkullimi për kamione" me kapacitet maksimal (3500-8000) kg	Për mjet	5.000
2.	Autorizim për lëvizje kundër sinjal rrugor "Ndalim qarkullimi për kamione" me kapacitet maksimal (8001-14000) kg	Për mjet	10.000
3.	Autorizim për lëvizje kundër sinjal rrugor "Ndalim qarkullimi për kamione" me kapacitet maksimal mbi 14000 kg	Për mjet	15.000

Shënim. *Këto Autorizime kanë afat kohor vlefshmërie jo më shumë se gjashtë muaj. Për dublikatë me të njëjtën përmbajtje dhe afat vlefshmërie paguhet 30% e vlerës së plotë.*

Struktura e ngarkuar për vjeljen: Struktura e ngarkuar për lëshimin e autorizimit dhe vjeljen e pagesës për këtë tarifë është Sektori i Shërbimeve, pranë Bashkise Malësi e Madhe.

II.13.Tarifa për dhënie licence për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj.

Baza ligjore: Ligji nr.8450,datë 24.02.1999,i ndryshuar neni 20 pika 2,VKM Nr.970, datë 02.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj",Kreu II,pika 1,germa b,pika 3. i ndryshuar me VKM nr.344,date 19.04.2017, Ligji 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 14 pika 5/ë.

Dhënia e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikante dhe të njësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga Bashkia Malësi, në rastet kur stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete, gazit të lëngshëm e vajrave lubrifikante dhe të njësive të shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, do të ndërtohen në territor të saj.

Nivelet e tarifës: Nivelet e tarifës për dhënie licence për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj janë të paraqitura si në tabelën më poshtë vijon:

Tabelë 24.

I.9– g) Tarifë për dhënie licenca për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj	Njësia	Niveli i tarifës
1- Dhënie dhe përsëritje e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve , gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, dhe vajrave lubrifikante	Lekë/liçencë	1 000 000
2- Dhënia e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, për veprimtarinë e tregtimit për përdorim nga konsumatorët fundorë.	Lekë/liçencë	100 000

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës: Ngarkohet Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Malësi e Madhe për llogaritjen dhe arkëtimin e këtyre tarifave.

II.14. Të ardhura nga dhënia me qera e aseteve në pronësi ose në përdorim.

Baza ligjore:VKM Nr.54,datë 05.02.2014 i ndryshuar, VKM nr.992,datë 09.12.2015 "Për përcaktimin kritereve të procedures dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore"(Pika 1 dhe 2), ligji nr.9232,datë 13.05.2015, Ligji nr.68/2017,datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 19,pika 1.

Sipas përcaktimeve ligjore pasuritë që jepen me qira janë ndërtesat, trualli i lirë, trualli i lirë funksional (jo nën ndërtesë), makineritë e pajisjet dhe linjat e prodhimit.

Të ardhurat nga qiratë paguhen nga përfituesi dhe shfrytëzuesi i pronës në pronësi të bashkisë, bazuar në kontratën e lidhur mes palëve.

Sektori Juridik,Njësia e Prokurimit dhe Sektori i Aseteve kryejnë procedurën e plotë të dhënies me qera deri në hartimin e kontratës dhe kërkojnë lëshimin e faturës nga ana e sektorit te Taksave dhe Tarifave Vendore. Ndjekja e zbatimit të kontratës kryhet nga sektori i Aseteve dhe sektori Juridik.

Kapitulli III: GJOBAT

III.1 GJOBAT PËR SHKELJET DHE KUNDRAVAJTJET ADMINISTRATIVE

Baza ligjore: Ligji Nr.10279,datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative",neni 6,pika b, neni 7,pika ç ,neni 10,pika 3 e neni 12 , ligji nr. 8224 datë 15.05.1997 " Për Policinë Bashkiake" i ndryshuar,neni 13, ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë",i ndryshuar,neni 25, ligji nr.9920,datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligji nr.164/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar neni 22, ligji nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore",neni 8 pika 2,neni 23,neni 9 pika 1,3 pika b,neni 54 pika n . Ligji nr.10463/2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve",VKM nr.1096/2015 "Për miratimin e rregullave,kushteve dhe procedurave per perdorim dhe menaxhimin e hapesires publike neni 4 ,12,dhe 14.ligji nr.10/2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8308 i datë 18.03.1998 "Për Transportet rrugore " i ndryshuar, Ligji nr.68/2017,datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 61,pika 5 dhe 6.

Gjobat do të aplikohen në rastet e kundravajtjeve administrative apo shkeljeve ligjore të ndryshme brenda territorit të administruar nga Bashkia Malësi e Madhe. Përgjegjëse për aplikimin dhe vjeljen e këtyre gjobave do të jenë zyrat/sektore të cilat i kanë nën administrim në bashkëpunim me strukturat e Policisë Bashkiake prane bashkise Malesi e Madhe.

Llojet dhe nivelet e gjobave per shkeljet dhe kundravajtjet administrative: Llojet dhe nivelet e gjobave per shkeljet dhe kundravajtjet administrative që parashikon këshilli bashkiak janë të paraqitura si më poshtë:

Tabele nr.24.

1.Niveli i gjobave për kryerjen e aktivitetit tregtarë pa liçensë, autorizim apo leje përkatëse te jetë si më poshtë :	
1.1.Mospaisje me leje për tregti ambulante, kantinë	1 000 deri në 5 000 lekë
1.2. Mospaisje me leje për shërbim me tavolina jashtë lokalit.	20 000 lekë
1.3. Mospaisje me leje për ushtrim aktiviteti "24 orë"	20 000 lekë
1.4. Mospaisje me leje për zënie të hapësirës publike • Veprimtarive të cilat do të zhvillohen në hapësirat publike.	5 000 deri në 10 000 lekë
1.5. Mospaisje me leje për vendosje reklame : • E thjeshtë • elektronike	20 000 lekë

1.6. Mospaisje me liçencë për tregtimin me pakicë të karburanteve dhe njësive të shitjes së lëndëve djegëse	20 000 lekë
2.Niveli i gjobave për dëmtim dhe ndërhyrje në infrastrukturën rrugore pa leje të posaçme të jetë si më poshtë:	
2.1.Dëmtim, bllokim, vjedhje pusete.	20 000 lekë
2.2 Demtim te trotuarit apo zenie e tij.	15 000 leke
3. Niveli i gjobave për dëmtim dhe ndërhyrje në rrjetin e ndriçimit rrugor pa leje të posaçme të jetë si më poshtë:	
3.1.Lidhjet e pamiratuara në rrjetin ajror,nëntokësor.	10 000 deri në 20 000 lekë
3.2.Dëmtimi i shtyllave të ndriçimit	15 000 deri në 20 000 lekë
3.3. Dëmtimi i ndriçuesve	10 000 deri në 20 000 lekë
3.4.Përdorimi i shtyllave të ndriçimit si suport për montimin e reklamave , kapjen e kabllove etj.	10 000 lekë
4. Niveli i gjobave për dëmtim dhe ndërhyrje në hapësirat e gjelbëra dhe publike të jetë si më poshtë:	
4.1. Dëmtimi i hapësirës publike të gjelbërta.	10 000 deri në 20 000 lekë
4.2. Dëmtim, prerje, krasitje e pemëve.	10 000 deri në 20 000 lekë
4.3. Zënie e hapësirë të gjelbër (tavolina, promocione)	20 000 lekë
4.4.Vendosje tabelash, pankartash, banderolash në pemët decorative.	10 000 lekë
4.5.Vendosje posterash, njoftimesh në pemët decorative.	200 lekë/copë
4.6.Mosndërtimi i bazamenteve të kontenierëve të mbetjeve urbane të subjekteve të ndërtimit për objekte mbi 5 kate.	10 000 lekë
5. Niveli i gjobave për inspektoriatin veterinar të jetë si më poshtë:	
5.1.Për mishin e therur të tregtuar të pa çertifikuar nga Inspektoriati Veterinar.	5 000 deri në 10 0000 lekë

5.2.Mbajtja e kafshëve të prodhimit brenda territorit të Bashkisë.	10 000 deri në 20 000 lekë Për herë të parë, për rast të përsëritur deri në konfiskimin të kafshës
5.3.Në rast të konstatimit të tregtimit të kafshëve të prodhimit jashtë tregjeve të miratuara nga Bashkia.	5 000 lekë
5.4.Në rast të konstatimit të therjeve të kafshëve të prodhimit jashtë vendeve të përcaktuara nga Bashkia Malësi e Madhe .	10 000 deri në 20 000 lekë Për herë të parë, për rast të përsëritur deri në konfiskimin të kafshës .

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e gjobave : Struktura e ngarkuar për llogaritjen dhe mbledhjen e këtyre gjobave është Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore si dhe zyrat e taksave pranë Njësive Administrative.

Struktura për vendosjen e gjobave : Struktura per vendosjen e gjobave administrative jane inspektoret e sektoreve përkatës si dhe Policia e Bashkiake.

Për zbatimin e këtyre penaliteteve ngarkohen të gjitha Sektorët në Bashki.

III. 2 Gjobat për mos shlyrjen në afat të detyrimit.

Baza ligjore: Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 "Per sistemin e taksave Vendore" i ndryshuar; Ligji nr.164/2014,datë 4.12.2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9920,datë 19.5.2008 " Për Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise"i ndryshuar,neni 114/1,Ligji Nr.10279,datë 20.05.2010 "Për Kundërvajtjet administrative",neni 6,pika b.

- ***Gjobat aplikohen*** vetëm për subjektet e tatueshme (që kanë detyrim pajisjen me NIPT).Afati i fundit për likuidimin e detyrimit vjetor të vitit aktual është data 20 qershor e po këtij viti.Baza e llogaritjes së gjobës për mos shlyerje përfshin detyrimet totale të gjithë vitit aktual që lindin nga tarifat e pastrimit dhe largimit të mbeturinave, tarifa e shërbimeve, taksa e tabelës për qëllime identifikimi, taksa e ndërtesës, taksa e truallit, etj., sipas faturës për pagesë.

Niveli i gjobave për mosshlyrje në afat të detyrimit: Niveli i gjobave për mosshlyrje në afat të detyrimit (taksa,tarifa) paraqitet si më poshtë vijon:

Tabelë nr.25:

Nr	Emertim	Njesia	Tarifa
III.2.a	Gjoba per mos shlyerje te detyrimeve tatimore Brenda afatit 20 prill. Nese subjekti i ri ose adresa sekondare e të rregjistrohen pas datës 20 prill,afati per shlyerjen e detyrimeve është 30 ditë pas datës së rregjistrimit.	Lek \ për çdo kundravajtje.	Për çdo ditë vonesë 0.06% e vlerës së detyrimit të papaguar (maksimumi 25%)
III.3	**Gjobat nga kontrollet dhe inspektimet tatimore.**		
III.3.a	Për mosafishim ne vend te dukshem te niptit.	Lek \ për kundravajtje	3.000
III.3.b	Për moslejim në ushtrimin e kontrollit të inspektorve të taksave në ambjentet e biznesit.	Lek \ për kundravajtje	20.000
III.3.c	Për mosafishim i çmimeve të shitjes.	Lek \ për kundravajtje	8.000
III.3.d	Për mosmbajtje të dokumentacionit tatimor të kerkuar me ligj.	Lek \ për kundravajtje	10.000

Struktura për vendosjen e gjobave : Struktura per vendosjen e gjobave administrative jane inspektoret e sektoreve përkatës si dhe Policia e Bashkiake.

Subjektet e reja si dhe adresat sekondare të çelura rishtazi kanë afat deri në 20 qershor për shlyerjen e detyrimit. Nëse çelja bëhet pas datës 20 qershor, afati i fundit për shlyerjen detyrimeve tatimore është 30 ditë pas datës së rregjistrimit.

Kapitulli IV: LEHTËSIRA FISKALE

Baza ligjore: Ligji Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen vendore " neni 35 pika 3, ligji nr.9632, datë 30.10.2010 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, neni 21, pika 5 germa a dhe b,ligji nr.7874,datë 17.11.1994 "Për statusin e veteranit te luftes kunder pushtuesve nazifashiste te popullit shqiptar",i ndryshuar,neni 13,ligji nr.7889,datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit",neni 16.

a.Përjashtime nga pagesa e Tarifes Familjare:Përjashtohen nga pagesat e *Tarifes Familjare*, në të cilën përfshihen:

1- Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave për kategorinë "Familje"

2 - Tarifa e shërbimeve publike "ndriçim, gjelberim" për kategorinë "Familje"

b.Kategoritë e përjashtuar nga pagesa e tarifës:Të gjitha kategoritë e mëposhtme:

1-Invalidët e punës (kryefamiljarë) me kushtin që të mos kenë në përbërje familjare përsona madhorë.(përveç bashkëshortit, bashkëshortes)

2-Veteranet e Luftes Anti-Fashiste Nacional Çlirimtare (kryefamiljarë) me kushtin që të mos kenë në përbërje familjare përsona madhorë.

3-Kategoria paraplegjikë, tetraplegjikë, të verbërit (kryefamiljarë) me kushtin që të mos kenë në përbërje familjare persona madhorë. (përveç bashkëshortit, bashkëshortes)

4-Kryefamiljarë pensionista me kushtin që të mos kenë në përbërje familjare persona madhorë. (përveç bashkëshortit, bashkëshortes)

5-Grate kryefamiljare me kushtin që të mos kenë në përbërje familjare persona madhorë.(përveç fëmijë nën 22 vjeç, student).

6- Për kategorinë "Familje" që kanë në përbërje te certifikatës familjare përsona me aftësi të kufizuar do të tarifohen në masën - 30 % të tarifës familjare.

Këto kategori duhet të paraqesin pranë Zyrës së Taksave dhe Tarifave Vendore të Njësive Administrative, dëshminë e gjendjes së tyre dhe më konkretisht:

1-Çertifikatën familjare.

2- Librezën përkatëse të statusit.

Kapitulli V: ANKIMI

Baza ligjore: Ligji nr.9920 datë 19.05.2008 „Për procedurat Tatimore në R.SH“ të ndryshuar me ligjin nr.164\2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar neni 38,neni 92,neni 106,pika 2.

Çdo taksapagues ka të drejte të ankohet me shkrim për shumën dhe mënyrën se si janë vleresuar detyrimet e tij nga zyrat e taksave, të kërkojë rimbursime si dhe të apeloje kundër çdo veprimi ose mosveprimi nga strukturat përkatëse në Bashkinë Malësi e Madhe.

Ankimi paraqitet me shkrim pranë Kryetarit të Bashkisë Malësi e Madhe,sipas kritereve dhe rregullave të vendosura nga këshilli bashkiak, brenda 30 ditëve nga marrja dijeni për aktin administrative.

Ky ankimim në përputhje me Ligjin “Për Proçedurat Tatimore” duhet të përmbajë:

a) emrin, adresen dhe NIPT-in e apeluesit;
b) vitin tatimor, me të cilin lidhet apelimi;
c) natyrën dhe shumën e tatimit ose gjobës që është subjekt apelimi;
d) baza ku mbështetet apelimi.

Subjekti duhet të përmbushë kërkesat e ligjit për parapagimin e detyrimeve përpara depozitimit të ankimit administrative.

Procedurat e apelimit dhe procedurat e shqyrtimit të apelimit tatimor, bazohen në përcaktimet e bëra, Ligjin nr.9920 datë “Për Proçedurat Tatimore” dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të tij. Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe shqyrton ankimin dhe merr vendim brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të ankimit.

Kundër vendimit të Kryetarit të Bashkisë Malësi e Madhe, subjekti ka të drejtë të ankohet në Gjykatë. Ankimimi bëhet brenda 30 ditëve nga çasti i marrjes në dijeni për vendimin e mësipërm.

Efektet financiare të paketës fiskale fillojnë që më datën 01.01.2018